

**ARTICLES OF ASSOCIATION
AND
BYLAWS
OF
NOTOS POWER ALBANIA SHPK**

*This day, on 14.11.2022, **Notos Power A.S.**, a joint stock company, established and organized in accordance with the laws of Czech Republic, registered with the Commercial Register, held by the Regional Court in Ostrava with registration business number 080 72 809, and with legal seat at the address: “Hrušovská 3203/13a, Moravská Ostrava, 702 00 Ostrava”, in the capacity of the sole shareholder, duly represented by Mr. Daniel Barc and Pavel Jakubik, as authorized by the Resolution of the Sole Shareholder of Notos Power A.S., dated 14.11.2022, through this document establishes a limited liability company in accordance with the legislation in force of the Republic of Albania and with the present act.*

Article 1

Denomination

Through this present act is regulated the organization and functioning of a limited liability company, denominated as **Notos Power Albania Shpk** (hereinafter referred to as the “**Company**”).

Article 2

Legal form

Notos Power Albania Shpk is a limited liability company, established and organized in accordance with the Albanian legislation and in particular with the provisions of Law no. 9901, dated 14.04.2008 “*On Entrepreneurs and Commercial Companies*”, as amended, and in compliance with this act.

Article 3

Registered Office

- 3.1 The legal seat of the Company shall be at the address: “*Rruga e Kavajës*”, ish Parku i Malirave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3, Tirana, Albania”.
- 3.2 The Administrator/s may establish and/or close subsidiaries, branches, agencies, and/or representation offices, either within or outside of the territory of the Republic of Albania.

Article 4

Duration

- 4.1 The Company shall perform its activity for an unlimited period of time, starting from the date of its registration with the Commercial Register, held by the National Business Center.

4.2 Dissolution and winding up of the Company shall be defined upon resolution of the Sole Shareholder, according to the provisions of the present document and the legislation in force.

Article 5

Object of activity

- 5.1 The Company, which is organized as a holding company, will own shares in several other special purpose vehicle companies engaged in renewable energy sector in Albania and will provide assistance to such companies owned directly or indirectly by the Company itself (hereinafter referred to as “**Companies of the Holding**”), and has as its scope of activity conducting activities, which will include but will not be limited to the following:
- a. Technical, administrative, financial and organizational coordination of all Companies of the Holding;
 - b. Instruction in setting objectives/goals and strategies, coordination of activities, setting financial objectives, audit/control of financial conduct and effectiveness and, in general, financial management and audit, as well as support in this direction of the Companies of the Holding;
 - c. Continuous advisory services for commercial activities, which shall include but will not be limited to studies and assistance for the incorporation and exercise of commercial activities in Albania, in accordance with the legislation on commercial companies in the Republic of Albania, assistance in drafting bylaws, maintaining the relevant books of commercial companies and fulfilling obligations near the relevant bodies, assistance with the preparation of business plans, assistance with the preparation and implementation of restructuring and cost reduction programs, assistance with the planning and implementation of extraordinary economic operations of companies (restructurings, mergers, divisions, increases of share capital, acquisitions of enterprises or their branches; transformations, closure and liquidation of companies);
 - d. Financial advice including but not limited to financial analysis for development strategies, preparation of financing plans, consulting and assistance in credit operations, study and research for financial resources with facilitating terms, assistance in real estate investment operations, and others fields;
 - e. Support in matters related to information technology and any other element for the infrastructure necessary to carry out the activity for each of the Companies of the Holding;
 - f. Advice and strategic instruction in the management of human capital for each of the Companies of the Holding in accordance with the respective strategy as well as the provision of human resources services for each of the Companies of the Holding in the field of budgeting, planning, recruitment and employment, compliance, analysis and metrics of human resources, performance management, career and professional development (training), salary and rewards system, employee relations, management of dismissal and etc., according to internal acts approved by the Sole Shareholder;
 - g. Assistance with policies and plans for risk management;
 - h. Providing analysis services, market studies and marketing for matters related to the activity of the Companies of the Holding;

- i. Providing guarantees of all kinds for each of the Companies of the Holding, and
- j. Any other service in function of the smooth running of the activity of the Company itself and the Companies of the Holding.

5.2 Notwithstanding the foregoing, the Company may perform any useful or necessary activities permitted by the applicable law for the realization of its object of activity.

Article 6

Share capital

6.1 The share capital of the Company is EUR 1.00 (one Euro).

6.2 The subscribed share capital of the Company consists of 1 (one) share having a value of EUR 1.00 (one Euro).

Article 7

Sole Shareholder

The Sole Shareholder of the Company is:

- *Notos Power A.S.*, a joint stock company established and organized in accordance with the laws of Czech Republic on 09.04.2019, registered with the Commercial Register, held by the Regional Court in Ostrava with registration business number: 080 72 809, and with legal seat at the address: "Hrušovská 3203/13a, Moravská Ostrava, 702 00 Ostrava", owner of 1 (one) share equal to 100% (a hundred percent) of the share capital in the amount of EUR 1.00 (one Euro).

Article 8

Increase and decrease of share capital

8.1 The share capital may be increased at any time, in one or more tranches, in accordance with the legislation in force, upon resolution of the Sole Shareholder.

8.2 The Company may decrease the share capital, upon resolution of the Sole Shareholder. In any case, the share capital cannot be reduced below ALL 100 (one hundred Albanian Lekë), which is the minimum value required by law.

Article 9

Transfer of the shares

The Sole Shareholder may decide to transfer the share through sale, donation, inheritance, or any other means provided by the legislation in force, at any time.

Article 10

Decision-making

10.1 The highest decision-making body of the Company is the Sole Shareholder.

10.2 The Sole Shareholder is responsible, *inter alia*, for resolutions regarding the following:

- i. setting of the business policies of the Company;
- ii. amendment of the Bylaws;
- iii. appointment and dismissal of administrator/s, legal auditor/s, and liquidator/s and their remuneration;
- iv. supervision of the implementation of commercial policies by administrators;
- v. increase and/or decrease of the capital of the Company;
- vi. transfer of share;
- vii. distribution of dividends;
- viii. re-organization and/or dissolution of the Company; and
- ix. any other matter set forth by the applicable legislation and this act.

Article 11

The Resolutions' Register

- 11.1 All resolutions made by the Sole Shareholder shall be registered in the Resolutions' Register, whose content may not be deleted or amended. In particular, the following resolutions shall be registered:
- i. approval of the financial statements and of the progress reports on the activity;
 - ii. distribution of profits and losses;
 - iii. increase or decrease of the share capital;
 - iv. resolutions with regard to investments;
 - v. re-organization and dissolution of the Company.
- 11.2 The foregoing list is not exhaustive and the resolutions, which are not registered in the Resolutions' Register, shall be deemed invalid.

Article 12

Administration

- 12.1 The Company shall be managed by one or more administrators.
- 12.2 The first Administrators of the Company, who shall have a mandate of 5 (five) years, are the following:
- **Mr. Daniel Barc**, a Czech citizen, born in Ostrava, on 10.04.1973, holder of passport with number 46674474;
 - **Mr. Pavel Jakubik**, a Czech citizen, born in Frydek-Mistek, on 14.10.1976, holder of passport with number 42269440.

- 12.3 The Administrator/s shall be appointed by resolution of the Sole Shareholder and may be dismissed at any time upon resolution of the same.
- 12.4 The specific powers of each Administrator shall be decided by the resolution of the Sole Shareholder and may be modified in the same way.
- 12.5 The Administrator/s will be natural person/s, without any restriction regarding nationality. The term of the mandate of the Administrator/s will be decided at the moment of the appointment, but in any case, may not exceed 5 (*five*) years. Notwithstanding this limitation, the duration of the mandate may be renewed upon resolution of the Sole Shareholder.

Article 13


Powers of the Administrators

- 13.1 The Administrators are responsible for the management of the Company and represent the Company towards third parties, in accordance with the provisions of the present document and the applicable legislation.
- 13.2 The powers and duties of the Administrators regarding the management and supervision of the activity of the Company shall include, but will not be limited, to the following:
- i. to implement the business policies of the Company and the resolutions of the Sole Shareholder;
 - ii. to ensure the compliance of the Company with the laws and accounting standards;
 - iii. to carry out all actions regarding the management of the business activity of the Company;
 - iv. to ensure regular maintenance of the financial and accounting documents of the Company;
 - v. to represent the Company towards third parties;
 - vi. to perform all mandatory registrations and publications regarding the Company as required under the legislation in force;
 - vii. to carry out other duties as provided by the law and by this document.
- 13.3 The Administrators may exercise all powers and actions, except for those, which by law, these Bylaws or resolutions of the Sole Shareholder are reserved to the Sole Shareholder.
- 13.4 The Administrators may delegate part of or all their powers to other persons.
- 13.5 Remuneration of the Administrators shall be decided upon resolution of the Sole Shareholder.

Article 14

Statutory Auditors

If required by law or approved by the Sole Shareholder, the audit of the financial statements and accounting records of the Company shall be entrusted to one or more statutory auditors.

5


Article 15

Financial year and financial statements

- 15.1 The financial year begins on the 1st day of the month of January and ends on the 31st day of the month of December of each year.
- 15.2 The first financial year begins on the date of registration of the Company with the Commercial Register and ends on the 31st day of the month of December 2022.
- 15.3 The annual financial statements, the inventory, and the report of the Administrator/s and legal auditor, if there is one, shall be approved by the Sole Shareholder pursuant to Law no. 9901, dated 14.04.2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended.
- 15.4 Approval of the documents relating to the financial statements will take place annually, within 6 (*six*) months from the end of the financial year.

Article 16

Dissolution and liquidation of the Company

- 16.1 The Company may be dissolved for the reasons listed in article 99 of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended, or upon the decision of the Sole Shareholder.
- 16.2 Excluding cases of insolvency, dissolution of the Company causes the commencement of the liquidation procedures under the solvency status.
- 16.3 The Sole Shareholder shall appoint one or more liquidators, determining their powers in compliance with the laws in force.
- 16.4 The Company will continue to exist as a legal entity for the purposes of the liquidation until the completion of the procedure. During such procedure, the wording "*under liquidation*" shall follow the denomination of the Company.

Article 17

Applicable law and settlement of disputes

- 17.1 The present document is based on Albanian legislation and its interpretation, and validity, the implementation shall be construed and enforced in accordance with the Albanian legislation. The provisions of law no. 9901 dated 14.04.2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended, shall apply for matters not regulated by this document.
- 17.2 In case of disputes or controversies that arise out of, or relate to the interpretation or execution of this document, the District Court of Tirana shall be competent to settle any claim or dispute.

The present document is drawn in 2 (two) copies in English and Albanian language.

For the **Sole Shareholder**

NOTOS POWER A.S.



DANIEL BARC

Daniel Barc



PAVEL JAKUBIK

Pavel Jakubik

AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
NOTOS POWER ALBANIA SHPK

*Sot, më 14.11.2022, **Notos Power A.S.**, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës Çeke, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Ostravë, me numër regjistrimi të subjektit 080 72 809, dhe me seli në adresën: “Hrušovská 3203/13a, Moravská Ostrava, 702 00 Ostrava”, në cilësinë e ortakut të vetëm, e përfaqësuar nga z. Daniel Barc dhe z. Pavel Jakubik, të autorizuar me Vendimin e Ortakut të Vetëm të Notos Power A.S., datë 14.11.2022, nëpërmjet këtij akti, themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me këtë dokument.*

Neni 1

Emërtimi

Nëpërmjet këtij akti rregullohet organizimi dhe funksionimi i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e emërtuar **Notos Power Albania Shpk** (këtu e në vijim referuar “**Shoqëria**”).

Neni 2

Forma Juridike

Notos Power Albania Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, dhe në veçanti, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: “*Rruga e Kavajës*”, ish *Parku i Mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3, Tiranë, Shqipëri*”.
- 3.2 Administratori/ët mund të hapë/in dhe/ose mbyllë/in filiale, degë, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, i mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

5.1 Shoqëria, e cila është e organizuar si një shoqëri holding, do të zotërojë kuota në disa shoqëri të tjera me qëllime të veçantë të angazhuara në sektorin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri dhe do t'u ofrojë asistencë këtyre shoqërive, në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë Shoqëria (këtu dhe në vijim: “**Shoqëritë e Holding-ut**”), dhe ka si fushë veprimtarie kryerjen e aktiviteteve, të cilat do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në sa vijon:

- a. Koordinimi teknik, administrativ, financiar dhe organizativ i të gjithë Shoqërive të Holding-ut;
- b. Orientim në vendosjen e objektivave dhe strategjive, koordinimin e aktiviteteve, vendosjen e objektivave financiare, kontrollin e sjelljes dhe efektivitetit financiar dhe në përgjithësi, menaxhimin dhe kontrollin financiar, si dhe mbështetjen në këtë drejtim të Shoqërive të Holding-ut;
- c. Shërbime të vazhdueshme këshillimi për aktivitetet tregtare, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në studime dhe asistencë për themelimin dhe ushtrimin e veprimtarive tregtare në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë, asistencë në hartimin e statuteve, mbajtjen e librat përkatës të shoqërive tregtare dhe përmbushjen e detyrimeve pranë organeve përkatëse, asistencë në përgatitjen e planeve të biznesit, asistencë në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të ristrukturimit dhe uljes së kostove, asistencë në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve ekonomike të jashtëzakonshme të shoqërive (ristrukturime, bashkime, ndarje, zmadhime kapitali, blerje sipërmarrjesh ose degësh të tyre; transformime, mbyllje dhe likuidim të shoqërive);
- d. Këshillim financiar duke përfshirë, por pa u kufizuar në analizat financiare për strategjitë e zhvillimit, përgatitjen e planeve të financimit, këshillim dhe asistencën në operacionet e kredisë, studimin dhe kërkimin për burime financiare me kushte lehtësuese, asistencë në operacionet e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe fusha të tjera;
- e. Mbështetje në çështjet që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe çdo element tjetër për infrastrukturën e nevojshme për realizimin e aktivitetit për secilën prej Shoqërive të Holding-ut;
- f. Këshillim dhe orientim strategjik në menaxhimin e kapitalit njerëzor për secilën prej Shoqërive të Holding-ut në përputhje me strategjinë përkatëse si dhe ofrimin e shërbimeve të burimeve njerëzore për secilën prej Shoqërive të Holding-ut në fushën e buxhetimit, planifikimit, rekrutimit dhe punësimit, përputhshmërisë, analizave dhe metrikave të burimeve njerëzore, menaxhimit të performancës, të karrierës dhe zhvillimit profesional (trajnitimit), sistemit të pagave dhe shpërblimeve, marrëdhënieve me punonjësit, menaxhimin e largimeve e të tjera, sipas akteve të brendshme të miratuara nga Ortaku i Vetëm;
- g. Asistencë me politika dhe plane për menaxhimin e riskut;

- h. Dhënien e shërbimeve të analizës, studimeve të tregut dhe marketingut për çështje që lidhen me aktivitetin e Shoqërive të Holding-ut;
- i. Dhënia e garancive të të gjitha llojeve për secilën nga Shoqëritë e Holding-ut; dhe
- j. Çdo shërbim tjetër në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë së vetë Shoqërisë dhe Shoqërive të Holding-ut.

5.2 Pavarësisht sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 6

Kapitali

6.1 Kapitali i Shoqërisë është EURO 1.00 (një Euro).

6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerën nominale prej EURO 1.00 (një Euro).

Neni 7

Ortaku i Vetëm

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- *Notos Power A.S., një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës Çeke, më 09.04.2019, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Ostravë, me numër regjistrimi të subjektit: 080 72 809, dhe me seli në adresën: "Hrušovská 3203/13a, Moravská Ostrava, 702 00 Ostrava", zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 100% të kapitalit themeltar në vlerën prej EUR 1.00 (një Euro).*

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë këste, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.

8.2 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e 100 (njëqind lekë Shqiptare) lekë, që është minimumi i vlerës së kërkuar nga ligji.

Neni 9

Transferimi i Kuotës

Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, trashëgimisë apo ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Vendimmarrja

- 10.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.
- 10.2 Ortaku i Vetëm është përgjegjës, *ndër të tjera*, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- i. përcaktimin e politikave të biznesit të Shoqërisë;
 - ii. ndryshimin e Statutit;
 - iii. emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve, ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesit/ve, si dhe për shpërblimin e tyre;
 - iv. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
 - v. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - vi. transferimin e kuotave;
 - vii. shpërndarjen e fitimeve;
 - viii. riorganizimin, dhe/ose prishjen e Shoqërisë; dhe
 - ix. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky akt.

Neni 11

Regjistri i Vendimeve

- 11.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në veçanti, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme:
- i. miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ii. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
 - iii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
 - iv. vendime në lidhje me investimet;
 - v. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.
- 11.2 Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe vendimet, të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 12

Administrimi

- 12.1 Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë.
- 12.2 Administratorët e parë të Shoqërisë, të cilët do të kenë mandat 5 (pesë) vjeçar, janë si në vijim:
- **z. Daniel Barc**, shtetas çek, i lindur në Ostravë më 10.04.1973, mbajtës i pasaportës me nr. 46674474;



- *z. Pavel Jakubik, shtetas çek, lindur në Frydek-Mistek, më 14.10.1976, mbajtës i pasaportës me nr. 42269440.*

- 12.3 Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 12.4 Kompetencat specifike të secilit Administrator do të vendosen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të ndryshohen në të njëjtën mënyrë.
- 12.5 Administratori/ët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

- 13.1 Administratorët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionin e zbatueshëm.
- 13.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorëve në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
 - sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
 - kryerjen e të gjitha veprimeve lidhur me administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
 - sigurimin e mbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;
 - kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë Statut.
- 13.3 Administratori/rët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj, nga ky Statut ose vendime të Ortakut të Vetëm janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.
- 13.4 Administratorët mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tyre tek persona të tjerë.
- 13.5 Shpërblimi i secilit Administrator mund të vendoset me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 14

Audituesi ligjor

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 15

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

- 15.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.
- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, dhe raporti i Administratorit/ërve dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 15.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.

Neni 16

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 16.1 Shoqëria mund të priset për arsyt e renditura në nenin 99 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ose me Vendim të Ortakut të Vetëm.
- 16.2 Duke përjashtuar rastet e falimentimit, prishja e Shoqërisë pasohet me fillimin e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.
- 16.3 Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me ligjin e aplikueshëm.
- 16.4 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi “*në likuidim e sipër*” vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 17

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 17.1. Ky akt bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar do të zbatohet për çështjet që nuk rregullohen nga ky dokument.
- 17.2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij akti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës do të jetë kompetente për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje.

Ky dokument përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.


Për ORTAKUN E VETËM

NOTOS POWER A.S.



DANIEL BARC

Daniel Barc



PAVEL JAKUBIK

Pavel Jakubik